



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 08.07.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 06.07.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “DWH ALBANIA” sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me paisje te instrumentit GPS dhe Total Station”, me Nr. të Prok: 632-20-3153-1-2-1, nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “DWH ALBANIA” sh.p.k, e dt. 06.07.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me paisje te instrumentit GPS dhe Total Station”, me Nr. të Prok: 632-20-3153-1-2-1, Nr. Brendshëm 632-20-044-121., kundër kundër Njoftimit për kontratë dhe Dosjes së tenderit, te AK –së, të datës 25.06.2020, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .

2. Vërtetohet NJOFTIM PËR KONTRATË DHE DOSJA E TENDERITI AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 25.06.2020;

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://www.e-prokurimi.rks-gov.net/>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “DWH ALBANIA” sh.p.k., me datë 06.07.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje te instrumentit GPS dhe Total Station”, me Nr. të Prok: 632-20-3153-1-2-1, Nr. Brendshëm 632-20-044-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 08.07.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Çuditërisht ju bini ne kundërshtim me ankesat tuaja te para! Ne ankesat paraprake doli qe totali ka probleme me specifikat, sot thoni qe totali është ne gare te hapur dhe GPS ka probleme! Për një gjeodet terreni e kupton shumë mire qe Kontrolleri zë një pozicion shume te rëndësishëm ne paketën GPS, çfarë kuptimi paska marrësi dhe softueri kur kontrolleri (ai qe ruan te dhënat) nuk është prodhim i fundit, pra te mos ketë rendimentin maksimal për pune ne terren!

Ne ankesat tuaja ne tenderët pararendës ishte kërkesa qe te ulet numri i kanaleve, dhe me ankesën tuaj ne e hoqëm fare numrin e kanaleve duke hapur garën për te gjithë!

AUTORITETIT KONTRAKTUES mbetet pranë NJOFTIM PËR KONTRATË DHE DOSJES SË TENDERITI të publikuar me datë: 25.06.2020.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Arkivit të Komunës

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së
